

URDHËR
Nr. 51, datë 1.2.2024

**PËR DELEGIMIN E KOMPETENCËS SË PËRFAQËSIMIT LIGJOR TË
MINISTRISË PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME NË PROCESET
GJYQËSORE**

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; në ligjin nr. 23/2015, “Për shërbimin e jashtëm të RSH-së”; në ligjin nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; në nenet 22 e vijuese të ligjit nr. 44, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës së ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, për përfaqësimin ligjor të institucionit në proceset gjyqësore, në të gjitha shkallët e gjykimit dhe në Gjykatën Kushtetuese.

2. Autorizimet për përfaqësimin ligjor të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme në proceset gjyqësore të nënshkruhen nga Sekretari i Përgjithshëm, në emër të personit apo personave që do të përfaqësojnë institucionin.

3. Përfaqësuesi i autorizuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme ka të drejtë të kryejë çdo veprim procedural të parashikuar nga legjislacioni në fuqi përpara gjykatave, prokurorisë, zyrave të përmbarimit gjyqësor, konform parashikimeve të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, përveç rasteve kur kjo e drejtë kufizohet në aktin e autorizimit.

4. Të gjitha aktet e nënshkruara para hyrjes në fuqi të këtij urdhri dhe që janë nxjerrë në zbatim të urdhrit nr. 317, datë 13.9.2023, “Për delegim kompetencash”, do të vazhdojnë të jenë të vlefshme deri në përfundimin e procesit gjyqësor përkatës.

5. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme për zbatimin e këtij urdhri.

6. Urdhri nr. 317, datë 13.9.2023, “Për delegim kompetencash”, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME
Igli Hasani